



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZËVËNDËSKRYEMINISTRI
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E STANDARDEVE MINERARE DHE INDUSTRIALE**

URDHËR

Nr. 182, datë 18.3.2013

PËR

**ANULLIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN E TË
DREJTËS PËR APLIKIM PËR LEJE MINERARE NË QENDRËN
KOMBËTARE TË LICENCIMIT PËR ZONEN MINERARE
KONKURRUESE Nr.737/2**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5 pika 3, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për Miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, pikës 5 dhe pikës 7 të VKM nr.320, datë 21.04.2011, “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, nr.127, datë 25.02.2013 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2013”, Urdhrit nr.134, date 28.02.2013,

U R D H E R O J:

1. Anulimin e Procedurave konkurruese për dhënie të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Licencimit për zonat minerare konkurruese nr.737/2, për arsye të mos rakordimit të të dhënave të tabelës me hartën digjitale të zonës.
2. Procedura konkurruese për zonën minerare nr.737/2 të zhvillohet me datë 15.04.2013.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet DREJTORIA E STANDARTEVE MINERARE DHE INDUSTRIALE.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



EDMOND HAXHINASTO